

**OPINIONI PUBLIK**  
**RRETH**  
**PRONESISE SE TE HUAJVE MBI TOKEN**  
**NE SHQIPERI**

**Llukan Puka, Prof.**

**Romeo Sherko, MSc.**

**Me mbështetjen e Forunit Kombëtar të Tokës (FKT) dhe Universitetit të Wisconsin**

**Tiranë, Dhjetor 2001**

**Ky studim u krye nga Forumi Kombëtar i Tokës (FKT) me mbështetjen financiare të Universitetit të Wisconsin-it në SHBA. Për realizimin e tij, bashkëpunuan studentë të degës së Informatikës të Fakultetit të Shkencave Natyrore. Grupi E&DA**

(lpuka@fshn.tirana.al) realizoi anketimin dhe përpunimin e të dhënave të anketës.

Qëllimi i tij ishte investigimi i opinionit publik për problemet e pronësise së të huajve mbi token në Shqipëri.

Ligjet aktuale, rregullojnë këtë problem për trojet; ndërkaq për token bujqësore, asnjë hapësirë ligjore nuk ekziston.

Disa vjet mbas miratimit të këtyre ligjeve, kushtet ekonomike e sociale kanë ndryshuar. Në mënyrë të natyrshme shtrohet problemi i modifikimit të tyre. Këtë e kërkojnë edhe politikat intgruese në Evropën e Bashkuar.

Për të vlerësuar opinionet e njerëzve në lidhje me mundësitë e ndryshme të modifikimit, u ndërtua një pyetësor dhe u organizua një anketim. Studimi që vijon bën paraqitjen e rezultateve. Studimi i kryer në Tiranë dhe në rrethinat e tij, mendohet gjithashtu si një përgatitje për një studim më të plotë që do të përfshinte të gjithë vendin.

Materiali është konfidencial. Botimi i tij, i plotë apo i pjesshëm, duhet të bëhet me miratimin e autorëve dhe të FKT. Përdorimi i rezultateve në të gjitha rastet duhet të shoqërohet me referencën përkatëse.

Autorët

Tiranë, Dhjetor 2001

# OPINIONI PUBLIK RRETH PRONËSISE SE TE HUAJVE MBI TOKEN NE SHQIPERI

## PJESA E PARE

### 1. HYRJE

Qëllimi i këtij studimi ishte të investigojë opinionin publik mbi problemet e pronësise së të huajve mbi token në Shqipëri.

Çështja e lejimit, me ose pa kufizime, ose e ndalimit të pronësise së të huajve është një nga çështjet që Shqipërisë do t'i duhet të trajtojë sa më shpejt, duke e parë edhe në perspektivën e përfshirjes së saj në Evropën e Bashkuar.

Ky pyetësor është një përpjekje e parë e vlerësimit të opinionit publik për këtë çështje. Synimet e tij ishin:

- Krijimi i një ideje të përgjithshme për opinionin e njerëzve, vlerësimi i përgjithshëm i tyre për problemin;
- Testimi i pyetësorit në praktikë me qëllim që të përgatitet një pyetësor më i detajuar, për vlerësimin e opinionëve në një bashkësi më të madhe personash, mundësisht, përfaqësuese për të gjithë vendin.

### 2. TE DHENA PER ANKETIMIN

#### a. Zgjedhja

Grupi i personave të anketuar u zgjodh në Tiranë,

- në qytet
- në fshatin e tij.

Ky grup përbëhet nga 280 persona të shpërndarë në mënyrë të barabartë në qytetin e Tiranës dhe në fshat.

#### b. Intervistimi

Në Tiranë intervistimi u realizua në banesat e qytetarëve ose në hyrje të tyre i orientuar sipas akseve kryesore të rrugëve duke u nisur nga qendra e Tiranës në të gjitha drejtimet: Rruga e Durrësit, Rruga e Kavajës, Tirana e Re, Rruga e Elbasanit, Rruga Ali Demi, Rruga Bajram Curri.

Në fshat, intervistat u realizuan në dalje të këtyre akseve, në fshatrat Sauk, Kamëz, Vaqarr, Ndroq, Yrshek, Kashar, në banesat e personave ose pranë tyre.

Intervistimi u krye drejtpërsëdrejti duke pyetur dhe duke marrë përgjigjet në momentin e intervistimit (face to face).

#### c. Çështjet e anketës

- Mendimi për ligjin 7980 për shitblerjen e trojeve
- Mendimi për shitblerjen e tokës bujqësore
- Shtimi apo lehtësimi i kufizimeve
- Arsyet e qëndrimeve të tilla
- Problemi i qiramarrjes dhe i afateve për këtë qëllim
- Me cilat drejtime lidhen më shumë kufizimet po që se duhen parë ato
- Cilat zona duhet të ruhen më shumë dhe cilat duhet të kenë përparësi
- Preferencat ndaj të huajve për këtë qëllim
- Ligja dhe pranimi në Evropën e Bashkuar

#### **d. Karakteristika të bashkësisë së vrojtuar**

Një pamje më e hollësishme e karakteristikave të bashkësisë së intervistuar tregohet në pjesën përkatëse në studim. Informacioni për këtë bashkësi preku:

- Të dhëna të natyrës demografike (mosha, seksi, punësimi, gjendja shoqërore, numri i fëmijëve, shkollimi)
- Të dhëna për natyrën e marrëdhënieve të tij me pronën në përgjithësi (ish-pronar ose jo, i ka marrë, i janë njohur ose është kompensuar, natyra e pronave që ka trashëguar ose që pretendon, prona të tjera në se ka përfituar mbas viteve 90)

#### **e. Data e intervistimit**

Të dhënat u mblodhën gjatë periudhës Nentor Dhjetor 2001.

Treguesit e gjetur janë kryesisht frekuencat e përgjigjeve të dhëna. Një vlerësim më i hollësishëm lidhet me shqyrtimin e këtyre karakteristikave sipas vendbanimit (qytet, fshat), sipas seksit (mashkull, femër), sipas raporteve me pronën, sipas grupmoshës, etj.

## PJESA E DYTE

### REZULTATE NGA ANKETA

#### 1. Mendimi për ligjin 7980

Parlamenti Shqiptar ka miratuar në vitin 1995, Ligjin 7980, datë 27 Korrik, “Për shitblerjen e trojeve”. Në këtë ligj, në nenin 5 thuhet:

**... Personave fizikë a juridikë të huaj iu lind e drejta të blejnë truall pasi të kenë arritur kryerjen e investimit në përputhje me lejen e ndërtimit, deri në një vlerë jo më të vogël se tre herë vlera e truallit sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave....**

Ndërkohë shitja e tokës bujqësore të huajve **nuk lejohet**.

Si fillim u kërkuar opinionimi i njerëzve në lidhje me këtë ligj. Në tabelën që vijon është formuluar pyetja dhe opsionet përkatëse.

#### Ju personalisht, mendoni se ligji 7980 për shitblerjen e trojeve...

	Përqindja
Eshte plotesisht i drejte...	<b>17.1</b>
Ligji eshte vjeteluar tashme, kufizimet duhen forcuar edhe me shume	<b>21.8</b>
Ligji eshte vjeteluar tashme, kufizimet e mesiperme duhet te lehtesohen	<b>7.9</b>
Ligji eshte vjeteluar tashme, te huajve u duhen dhene te drejta te plota per shitblerjen e trojeve	<b>7.9</b>
Ligji eshte vjeteluar tashme, te huajve nuk u duhet dhene fare e drejta per shitblerjen e trojeve	<b>45.4</b>
Total	<b>100.0</b>

Shihet se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, duke pranuar se ligji është vjetëruar tashmë, anojnë nga ideja se të huajve nuk u duhet dhënë fare e drejta për shitblerjen e trojeve. Po t'i shtohet kësaj pjese edhe qëndrimi i atyre që duke pranuar se ligji është vjetëruar, janë për forcimin e kufizimeve, atëherë janë gati 67% e njerëzve që janë **për qëndrime shtrënguese** për problemin.

Reagimi, 10 vjet mbas ndryshimit të sistemit politik, duket pakëz i fortë, dhe kërkon shpjegime të tjera. Por me siguri ai mbart me vete si rrimishenca të kohës së kaluar, ashtu edhe një lloj nacionaliteti. Njw lloj ndikimi nw kwtw qwndrim duhet tw ketw edhe

mendimi sipas tw cilit gjendja ekonomike e vendit wshtw edhe pasojw e politikave qw tw huajt zbatojnw nw Shqipwri. Varfërimi i një pjese të konsiderueshme të popullatës në raport me tjetrën e cila u pasurua shpejt, ndikon gjithashtu në këtë qëndrim.

Opinionet qytet fshat nuk dallohen nga njëri tjetri siç e tregon tabela që vijon:

### Shperndarja e opinioneneve per ligjin sipas vendbanimit

*% within vendbanimi*

	Vendbanimi		
	qytet	fshat	Total
ligji drejte	16.9%	17.4%	17.1%
ligji veteruar, kufizime në punë, kushtet	19.0%	24.6%	21.8%
ligji veteruar, kufizime në punë, kushtet	9.9%	5.8%	7.9%
ligji veteruar: te huajt duhet te kene te drejte te plots	8.5%	7.2%	7.9%
ligji veteruar: te huajt nuk duhet t'ju dhene fare e drejta	45.8%	44.9%	45.4%
Total	100.0%	100.0%	100.0%

Pothuajse i njëjti qëndrim vihet re edhe për **tokën bujqësore**:

**Ju personalisht mendoni se legjislacioni  
ekzistues per shitblerjen e tokes bujqesore...**

	Perqindja
Duhet te mbetet si eshte	<b>65.4</b>
Duhet te ndryshoje ne perputhje me zhvillimet e vendit	<b>34.6</b>
Total	<b>100.0</b>

Vihet re se shumica është që **ai të mbetet ashtu si është**, me fjalë të tjera të mos lejohet shitja e tokës bujqësore të huajve.

Opinionet qytet-fshat dallohen nga njëri tjetri, shih tabelën që vijon:

### Shperndarja e opinioneneve per token bujqesore sipas vendbanimit

*% within vendbanimi*

	Vendbanimi		
	qytet	fshat	Total
te mbetet si eshte	59.9%	71.0%	65.4%
te ndryshoje ne perputhje me zhvillimet	40.1%	29.0%	34.6%
Total	100.0%	100.0%	100.0%

Shihet se fshati nuk është shumë i prirur për ta ndryshuar gjendjen, por preferon të

ruajë situatën në të cilën toka bujqësore ndalohet të blihet nga të huajt.

Sidoqoftë për ta bërë më të qartë vlerësimin e dhënë për problemin e mësipërm, u kërkua opinioni për një sërë çështjesh. Me fjalë të tjera u synua të shihej jo një qëndrim në bllok, pro ose kundër modifikimit të ligjit.

Rezultatet e anketimit tregohen në tabelën që vijon:

**Me konkretisht, me tregoni ju lutem se cili nga mendimet qe vijone eshte me afer mendimit tuaj...**

	Perqindja
Te jete i ngjashem me legjislacionin per shitblerjen e trojeve	6.1
Kufizimet te jene me te forta	20.4
Kufizimet te jene me te lehta	7.1
Te huajve t'u jepen te drejta te plota per shitblerjen e tokes bujqesore	6.1
Te huajve te mos u lejohet fare shitblerja e tokes bujqesore	60.4
Total	100.0

Situata e vrojtuar është thujse po ajo. Duke lënë mënjanë pjesën e atyre që është “kundër”, pjesa e atyre që është “pro”, mendon se në rast të një ligji, kufizimet duhen lehtësuar deri në masën e dhënies së të drejtave të plota të huajve.

## 2. Arsyet

Sipas qëndrimit të shprehur në lidhje me problemin e mësipërm, u synua të viley opinioni i secilit grup për arsyet e ndryshme që e shtyjnë secilin drejt këtij qëndrimi. Ata u ndanë në **tre grupe**: grupi i atyre që janë për një zgjidhje në analogji me ligjin për trojet, grupi i atyre që mendojnë se kufizimet në ligj duhet të lehtësohen, grupi i atyre që janë për kufizime më të forta deri në moslejimin total të të huajve në këtë proces.

Për grupin e parë, pra për ata që mendojnë se ligji për tokën bujqësore duhet të jetë i ngjashëm me atë të trojeve, rezultatet tregohen në tabelën që vijon:

**Ju personalisht mendoni se ky eshte qendrimi me i drejte sepse (baza 17)**

	Perqindja
I detyron te huajt te investojne ne token e blere	82.4
Siguron nje lloj kontrolli te shqiptareve mbi token e blere nga te huajt	17.6
Total	100.0

Të gjithë këta qëndrimin e tyre pothuajse e mbështesin në **argumentin investim**,

që është edhe kufizimi kryesor në rastin e trojeve. Për këtë grup, në përgjithësi nuk ekziston shqetësimi se do të humbasë kontrolli i shqiptarëve mbi truallin e tyre.

Për grupin e dytë, pra për ata që mendojnë se kufizimet duhet të jenë më të lehta se ekzistueset dhe/ose që të huajve t'u jepen të drejta të plota të shitblerjes së tokës bujqësore, rezultatet janë:

**Ju personalisht mendoni se ky është qëndrimi me i drejte sepse (baza 38)**

	Perqindja
Ata mund te investojne me shume	39.5
Rritet prania e te huajve ne Shqiperi dhe kjo eshte garanci per sigurine e saj	10.5
Shtohen shanset per integrimin ne Europe	23.7
Keshtu shqiptaret fitojne dhe do te kene mundesi te investojne vete	26.3
Total	100.0

Edhe këtu si element kryesor mbetet **investimi**, rreth 40% mendojnë se në këtë mënyrë rriten shanset për investime. Por nga ana tjetër, mjaft shohin në këtë zgjidhje edhe shanse më të mëdha të shqiptarëve për të fituar vetë e po ashtu edhe shanse më të mëdha për integrimin e Shqipërisë në Evropë. Problemet e sigurisë së Shqipërisë nuk janë argument themelor për të justifikuar qëndrimin.

Së fundi, grupi i atyre që anojnë nga moslejimi i të huajve, i sheh argumentet e veta të shpërndarë si vijon:

**Ju personalisht mendoni se ky është qëndrimi me i drejte sepse (baza 225)**

	Perqindja
Ruhet pavaresia dhe integriteti i Shqiperise	17.3
Toka eshte e shqiptareve dhe duhet t'u mbetet atyre	59.6
Ka shume te ngjare qe token e shqiptareve ta blejne fqinjët dhe ky eshte nje rrezik per vendin	20.4
Tjeter	2.7
Total	100.0

Vini re se shumica, rreth 60%, reagon nga pozita "nacionaliste". Po t'u shtohen këtyre edhe dy qëndrimet e tjera të së njëjtës natyrë, del se ky shfaqet si argumenti kryesor për reagimin e popullatës. Opsioni "tjetër", i cili do t'u jepte shanse argumenteve të një natyre tjetër, është i papërfillshëm.

### 3. Dhënia me qira, afatet



Sidoqoftë, u anketua edhe alternativa e dhënies me qira të tokës bujqësore. Në këtë rast, qëndrimi sikur zbutet, shihni tabelën që vijon:

**Ju personalisht si mendoni ne lidhje me mundesine e dhenies me qera te tokes bujqesore per nje afat te gjate si alternative e shitblerjes**

	Perqindja
Toka bujqesore mund t'u jepet te huajve me qera me afat te gjate	<b>86.1</b>
Toka bujqesore duhet te perdoret vetem nga shqiptaret	<b>13.9</b>
Total	<b>100.0</b>

Shihet se shumica kryesore, rreth 86%, janë që **toka bujqësore të jepet me qira** dhe vetëm 14% janë që toka të përdoret vetëm nga shqiptarët.

Qiraja shihet edhe si një mundësi për të jetuar në mënyrë komode pa humbur të drejtat e pronësisë, aq të rëndësishme në një perspektivë afatgjatë dhe të forta për mentalitetin vendas.

Megjithëse siç e thamë, zbutet qëndrimi në lidhje me dhënien e tokës të huajve, kur vjen puna për dhënien e saj me qira, po të shohim afatet me të cilat ajo duhet dhënë, del përsëri në pah “konservatorizmi”, “frika”, mentaliteti për ta konservuar si pronë të vetën, shihni tabelën që vijon:

**Sipas mendimit tuaj cili do te ishte afati maksimal i qerases?**

	Perqindja	Perqindja e grumbulluar
deri ne 10 vjet	<b>52.7</b>	<b>52.7</b>
deri ne 40 vjet	<b>19.9</b>	<b>72.6</b>
deri ne 80 vjet	<b>3.3</b>	<b>75.9</b>
deri ne 100 vjet	<b>9.1</b>	<b>85.1</b>
pa kufizim kohe	<b>14.9</b>	<b>100.0</b>
Total	<b>100.0</b>	

Prej saj shihet se **afati maksimal që propozohet nga shumica është deri në 10 vjet.**

Nga ana tjetër rreth 20% janë për qira që shkojnë deri në 40 vjet dhe rreth 15% mendojnë të mos ketë kufizim kohe.

Opinionet nuk dallohen shumë kur shihet shpërndarja sipas vendbanimit, qytet-fshat: të dy palët janë po aq të kujdesshëm për dhënien me qira, bile qyteti disi më shumë. Për hollësi të tjera shihni tabelën që vijon

### Shperndarja e opinioneve sipas vendbanimit per afatet e qerases

*% within vendbanimi*

		vendbanimi		
		qytet	ishq	Total
afat maksimal	deri ne 10 vjet	55.0%	50.4%	52.7%
	deri ne 30 vjet	22.5%	17.4%	19.9%
	deri ne 80 vjet	3.3%	3.3%	3.3%
	deri ne 100 vjet	8.3%	9.9%	9.1%
	pa kufizim kone	10.8%	19.0%	14.9%
Total		100.0%	100.0%	100.0%

Ndërkaq **sipas moshës** qëndrimet tregohen në tabelën që vijon:

### Shperndarja e opinioneve per afatet sipas moshes

*% within mosha*

		mosha				
		20-30	30-40	40-50	50-60	mbi 60
afat maksimal	deri ne 10 vjet	46.9%	58.5%	48.1%	47.4%	67.9%
	deri ne 30 vjet	12.5%	20.0%	22.1%	26.3%	14.3%
	deri ne 80 vjet	3.1%	1.5%	5.2%	5.3%	
	deri ne 100 vjet	12.5%	6.2%	9.1%	10.5%	10.7%
	pa kufizim kone	25.0%	13.8%	15.6%	10.5%	7.1%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Prej saj shihet se **në përgjithësi të gjitha moshat reagojnë njëllë në lidhje me afatet e qirasë.**

#### 4. Ç'loj kufizimesh?

Cilat janë mendimet në lidhje me kufizimet që duhen vënë për të huajt? U propozuan disa si të mundshme:

- **zona gjeografike,**
- **shtetësia e blerësit,**
- **lloji i investimit** që duhet të bëhet,
- **sipërfaqja e tokës** që mund të jepet për t'u shitur, blerë ose dhënë me qira,
- **lloji i taksave** që duhet paguar.

Përfundimet e anketimit tregohen në tabelat që vijojnë

### a. Për zonën gjeografike

Ne se duhet te kete kufizime per te huajt, ju personalisht mendoni se ato duhet te lidhen me.....zonen gjeografike, sepse sipas jush, disa zona kane perparesi ne lidhje me te tjerat per shitjen e tokes te huajve

		Procenta
jo		57.9
po		42.1
Total		100.0

Shumica mendon se zona gjeografike nuk ka pse të përfshihet në kufizimet për të huajt gjatë hartimit të një ligji të mundshëm. Por sidoqoftë nuk është e vogël pjesa e atyre që mendojnë të kundërtën.

### b. Shtetësia

Edhe shtetësia nuk është një problem që duhet marrë në konsideratë sipas shumicës së të anketuarve, shih tabelën.

Ne se duhet te kete kufizime per te huajt, ju personalisht mendoni se ato duhet te lidhen me.....shtetesine e bleresit, sepse sipas jush, te huajt nuk duhen konsideruar te barabarte kur eshte fjala per shitjen e tokes

		Procenta
jo		83.9
po		16.1
Total		100.0

Rreth 84% mendojnë se të huajt duhen konsideruar të barabartë kur është fjala për shitjen e tokës.

### c. Lloji i investimit

Në këtë rast opinionet ndahen, gati gjysma janë për ta marrë në konsideratë dhe gjysma tjetër jo, shih tabelën:

Ne se duhet te kete kufizime per te huajt, ju personalisht mendoni se ato duhet te lidhen me .....llojin e investimit qe kerkon te beje sepse sipas jush, disa investime jane me te rëndesishme se disa te tjera

		Perqindja
<input type="checkbox"/>	jo	50.7
<input type="checkbox"/>	po	49.3
Total		100.0

#### d. Taksat që duhet të paguajë

Për këtë tregues, **shumica janë që të merret parasysh** në lidhje me kufizimet e mundshme për shitjen e tokës të huajve

Ne se duhet te kete kufizime per te huajt, ju personalisht mendoni se ato duhet te lidhen me .....taksat qe duhen paguar, sepse sipas jush, sistemi i taksave qe duhet te paguaje nje i huaj per token nuk duhet te jete i njejte me shqiptaret

		Perqindja
<input type="checkbox"/>	jo	46.1
<input type="checkbox"/>	po	53.9
Total		100.0

#### e. Sipërfaqja e tokës që do të blihet

Edhe për këtë tregues, si për disa të tjerë, shumica janë që të mos ketë kufizime në lidhje madhësinë e sipërfaqes që mund të blihet nga të huajt

Ne se duhet te kete kufizime per te huajt, ju personalisht mendoni se ato duhet te lidhen me .....siperfaqen e tokes qe do te bleje, sepse sipas jush, duhen vendosur disa kufizime per madhesine e siperfaqes qe mund te blihet nga te huajt

		Perqindja
<input type="checkbox"/>	jo	65.7
<input type="checkbox"/>	po	34.3
Total		100.0

#### f. Cila është zona gjeografike ku ligja për shitblerjen e tokës nga të huajt duhet të lejohet më vonë?

Për të bërë më të qartë qëndrimin e atyre që e konsiderojnë zonën gjeografike si

një element të rëndësishëm kufizimi për të huajt, u vlerësuan opinionet e tyre në lidhje me disa zona që potencialisht paraqesin interes për ta. Rezultatet janë:

**Sipas jush cila eshte zona gjeografike me e rendesishme ku ju mendoni se ligji per shitblerjen e tokes nga te huajt duhet te lejohet me vone (baza 118)**

	Pe fundi
Tirana	32.2
Zona turistike bregdetare	61.0
Zona turistike malore	5.1
Zona rurale	.8
Fitet	.8
<b>Tota</b>	<b>100.0</b>

Shihet se peshën kryesore e zënë zona turistike bregdetare dhe Tirana, për të cilat nga njëra anë interesimi i të huajve është më i madh dhe nga ana tjetër opinionet kërkon t'i mbrojtë. Shqetësimi është i vogël për pjesët e tjera, si zonën turistike malore ashtu edhe zonën rurale.

**g. Cila është preferenca për të huajt?**

Së fundi, në këtë pjesë, u vlerësuan opinionet për preferencat ndaj të huajve nga të gjithë ata që e konsiderojnë shtetësinë si një element të rëndësishëm kufizimi për procesin e shitblerjes së tokës nga të huajt. Shtetasit e huaj u klasifikuan në disa kategori:

- shtetas nga vende fqinjë,
- shtetas nga vendet ballkanike,
- shtetas nga Evropa,
- shtetas nga SHBA dhe
- të tjerë.

Prej të intervistuarve u kërkua që të shpreheshin me një radhë preference për secilin grup, duke filluar me numrin 1 për më të preferuarin dhe duke mbaruar me numrin 5 për të fundit.

Rezultatet e klasifikimit për secilin grup tregohen në tabelat që vijojnë:

Preferenca për shtetasit nga vendet fqinje:

**Ne qofte se te huajt nuk duhen konsideruar te barabar midis tyre, atehere cila duhet te jete radha e preferen**  
**Preferenca per shtetasit nga vendet fqinje (baza 54)**

	Perqindja	Perqindja e grumbulluar
1	25.9	25.9
2	11.1	37.0
3	18.5	55.6
4	40.7	96.3
5	3.7	100.0
Total	100.0	

Preferenca për shtetasit nga vendet ballkanike:

**Ne qofte se te huajt nuk duhen konsideruar te barabar midis tyre, atehere cila duhet te jete radha e preferen**  
**Preferenca per shtetasit nga vendet ballkanike (baza 54)**

	Perqindja	Perqindja e grumbulluar
2	14.8	14.8
3	48.1	63.0
4	35.2	98.1
5	1.9	100.0
Total	100.0	

Preferenca për shtetasit nga vendet e Evropës:

**Ne qofte se te huajt nuk duhen konsideruar te barabar midis tyre, atehere cila duhet te jete radha e preferen**  
**Preferenca per shtetasit nga Evropa (baza 54)**

	Perqindja	Perqindja e grumbulluar
1	37.0	37.0
2	42.6	79.6
3	18.5	98.1
4	1.9	100.0
Total	100.0	

Preferenca për shtetasit nga SHBA:

**Ne qofte se te huajt nuk duhen konsideruar te barabart midis tyre, atehere cila duhet te jete radha e preferen**  
**Preferenca per shtetasit nga SHBA (baza 54)**

	Perqindja	Perqindja e grumbulluar
1	35.2	35.2
2	29.6	64.8
3	11.1	75.9
4	22.2	98.1
5	1.9	100.0
Total	100.0	

Duke gjykuar **nga vendi i parë**, shihet se:

- **preferencën më të madhe e kanë shtetasit nga Evropa dhe pastaj,**
- **me një rezultat të afërt, shtetasit nga SHBA.**

Larg prej tyre vijnë shtetasit nga vendet fqinje.

Vini re se shtetasit nga vendet ballkanike nuk klasifikohen në asnjë rast në vend të parë. A është kjo edhe një herë një shprehje tjetër e të qenurit ballkanas?

Edhe **duke i klasifikuar sipas dy vendeve të para, renditja nuk prishet.**

## **5. Integrimi në Evropën e Bashkuar dhe nevoja e një legjislacioni që u garanton të huajve të drejtat e pronësisë**

Problemi i fundit i shqyrtuar, lidhej me **informimin** që kanë shqiptarët për kërkesat e pritshme të Evropës, sipas të cilave, ndër të tjera, është e nevojshme që të huajve t'u garantohet me ligj e drejta e pronësisë mbi tokën. Rezultatet e anketës tregojnë se në përgjithësi kjo nuk konceptohet si e tillë.

**A e dini se nje nga kushtet e pranimi te Shqiperise ne Evropen e Bashkuar eshte kerkesa qe t'u sigurohet te hua e drejta e pronesise mbi token ne Shqiperi? (baza 275)**

	Perqindja
jo	73.5
po	26.5
Total	100.0

Por nga ana tjetër shumica e njerëzve e konsideron të drejtë kërkesën në rast se ky është një kusht për t'u përfshirë në Evropën e Bashkuar. Nuk është sidoqoftë i vogël numri i atyre që mendojnë të kundërtën, shih tabelën:

**Ju personalisht si mendoni ne lidhje me  
kerkesen? (baza 277)**

	Perqindja
Te pranohet kerkesa dhe te garantohet me ligj e drejta e te huajve	73.6
Te mos pranohet kerkesa edhe sikur kjo te sjelle mospranimin e Shqiperise ne Evrope	26.4
Total	100.0



## TE DHENA PER BASHKESINE E VROJTUAR

### I. Tregues Demografikë

Për secilin nga treguesit

- seks,
- moshë,
- shkollim,
- punësim,
- lloji i punës,
- gjendja shoqërore.

të dhënat janë përmbledhur në tabelat që vijojnë.

Tabela e parë tregon edhe se mbi sa të dhëna është mbështetur secili nga rezultatet.

#### Statistika

	seksi	mosha	shkollimi	punesimi	lloji i punes	gjendja shoqerore
N Valid	276	279	275	276	146	279
Missing	4	1	5	4	134	1

Rezultatet e anketimit tregojnë se rreth 55% e të anketuarve kanë qenë meshkuj dhe pjesa tjetër, rreth 45%, kanë qenë femra.

#### Shperndarja e zgjedhjes sipas seksit

	Perqindja
mashkull	55.1
femer	44.9
Total	100.0

Pjesa kryesore e të anketuarve, rreth 30% e ka zënë grupmosha 40-50 vjeç. Së bashku me grupmoshën 30-40, rreth 25%, këta përbëjnë rreth 55% të të anketuarve, pra më shumë se gjysmën. Sidogoftë janë vjelë edhe opinionet e më të rinjve, 20-30 vjeç, dhe më të moshuarve, 50-60 vjeç.

#### Shperndarja e zgjedhjes sipas moshes

	Perqindja
20-30	14.3
30-40	24.7
40-50	30.1
50-60	16.1
mbi 60	14.7
Total	100.0

Edhe shkollimi ruan të njëjtat tipare që ka e gjithë popullata. Shumica e të anketuarve janë me arsim të mesëm dhe çereku me arsim të lartë. Rezultatet shprehin edhe pamjen që ka shkollimi te ne.

**Shpërndarja e zgjedhjes sipas shkollimit**

	Perqindja
tetevjecar	18.5
i mesem	55.6
i larte	25.8
Total	100.0

Tabela që vijon tregon se si janë shpërndarë të anketuarit sipas punës që kryejnë. Shifra 48% e treguar më poshtë për të papunët duhet interpretuar drejt, sepse aty përfshihen si punonjësit e fshatit, të cilët e konsiderojnë veten e tyre të papunë, ashtu edhe pensionistët.

**Spërndarja e zgjedhjes sipas punesimit**

	Perqindja
ne sektorin publik	19.2
ne sektorin privat	34.1
pa pune	46.7
Total	100.0

Ndërkaq, rreth 1/3 e të anketuarve janë drejtues ose pronarë.

**Shpërndarja e zgjedhjes sipas llojit të punës**

	Perqindja
punonjes i zakonshem	67.1
drejtues ose pronar	32.9
Total	100.0

Shpërndarja e zgjedhjes sipas gjendjes shoqërore tregohet në tabelën që vijon.

**Shpërndarja e zgjedhjes sipas gjendjes shoqërore**

	Perqindja
Valid i martuar	88.5
beqar	7.5
i ve	3.9
Total	100.0

**II. Tregues të marrëdhënieve me pronën**

Të dhënat e mëposhtme tregojnë se ç'përfaqëson me pronën dhe pronësinë bashkësia e vrojtuar. Mendohet se ajo ndikon në opinionet që shfaqin njerëzit në lidhje me pronën dhe pronësinë e të huajve mbi token bujqësore në Shqipëri.

Tabela e parë tregon rreth 63% e të anketuarve e konsiderojnë veten pronarë nga e kaluara

**A keni trashëguar prona nga e kaluara,( baza 279)**

	Perqindja
jo	36.9
po	63.1
Total	100.0

Shumica kryesore e të gjithë atyre që e quajnë veten e tyre me prona nga e kaluara, rreth 75%, kanë tentuar pas vitit 1990 pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave që t'iu kthehen ose t'iu kompensohen ato.

**A keni tentuar pas 1990 pranë komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave që t'ju kthehen pronat ose të kompensoheni për to (baza 169)**

	Perqindja
jo	26.6
po	73.4
Total	100.0

Por vetëm 22% e tyre konsiderojnë se i kanë marrë ose janë kompensuar për të gjitha pronat e tyre. Rreth 4% janë ata që konsiderojnë se i kanë marrë një pjesë ose janë kompensuar. Po t'iu shtohet kjo pjesë atyre që mendojnë se kanë ende për të marrë ose për t'u kompensuar, atëherë masa e atyre që janë bërë pronarë ose janë kompensuar pjesërisht është rreth 40%.

Ndërkaq rreth 38% mendojnë se as kanë marrë pronat dhe as janë kompensuar për to, shih tabelën që vijon:

**A i keni marrë ose jeni kompensuar (baza 165)?**

	Perqindja
jane kthyer te gjitha..	22.4
nje pjese me jane kthyer, te tjerat kompensim	3.6
ka ende per te marre ose kompensuar	35.8
as kthyer as kompensuar	38.2
Total	100.0

Tabela që vijon jep të dhëna se si janë të shpërndara llojet e ndryshme të pronave midis popullatës së vrojtuar.

Nga ana tjetër, po të grupohen rezultatet, del se shumica e konsiderojnë veten nga e kaluara, pronarë për tokat bujqësore (përveç të tjerave), këta janë rreth 82% e popullatës së anketuar. Rreth 42% konsiderojnë se kanë trashëguar nga e kaluara troje. Rreth 21% konsiderojnë se kanë trashëguar nga e kaluara ndërtesa.

**Më thoni ju lutem se të çfarë lloji kanë qenë pronat tuaja (baza 171)**

	Perqindja
ndertesa	4.1
troje	6.4
toke bujqesore	45.0
te tjera	.6
12	2.9
13	4.1
14	.6
23	21.6
24	.6
34	3.5
123	8.2
134	1.2
234	1.2
Total <sup>a</sup>	100.0

a. 1. Ndertesa, 2. Troje, 3. Toke bujqesore, 4. Te tjera

Së fundi tabela që vijon tregon se ç'kanë përfituar mbas vitit 1990 të intervistuarit. Dy zërat kryesorë dhe që kanë peshën kryesore në rezultatin e mëposhtëm, ndërtesa dhe tokë bujqësore, mendojmë se lidhet kryesisht me procesin e privatizimit të banesave dhe të tokës bujqësore në fshat. Shumica konsideron që nuk ka përfituar ndonjë pronë.

**Më thoni ju lutem se ç'lloj pronash të tjera keni përfituar mbas vitit 1990 (jo nga ato të trashëguarat, për ata që kanë trashëguar) (shëno vetëm njerën nga përgjigjet),( baza 262)?**

	Perqindja
ndertesa, apartamente	36.6
troje	2.7
toke bujqesore	12.2
ndertesa dhe troje	1.1
ndertesa dhe toke bujqesore	1.1
troje dhe toke bujqesore	1.5
ndertesa, troje, toke bujqesore	1.1
tjeter	.4
nuk kam perfituar	43.1
Total	100.0